



Viti i X-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2019

KONTROLLI IM ELEKTRONIK

Valter Popaj*, Besmir Kanushi*

*Departamenti i Inxhinierive, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Albanian University

Adresë kontakti: valterpopaj@gmail.com;

kanushi@albanianuniversity.edu.al

Përmbledhje

Projekti që do të paraqesim ka të bëjë me një pajisje elektronike, e cila kryen shumë/disa funksione, të cilat na nevojiten për të qenë sa më të shëndetshëm gjatë qëndrimit përpara kompjuterit.

Pajisja quhet "Kontrolli im elektronik", e cila luan një rol shumë të rëndësishëm në punën tonë të përditshme në kompjuter. Pajisja do të na kontrollojë në mënyrë të pavarur gjatë qëndrimit para ekranit të kompjuterit. Ajo do të mbikëqyrë në mënyrë tepër strikte qëndrimin që ne mbajmë para kompjuterit, pra si do ta mbajmë shtyllën kurrizore, shpatullat etj. Me këtë pajisje ne bëjmë të mundur ruajtjen e distancës fizike me monitorin. Pajisja kontrollon vazhdimisht kapsitjen e syve, e cila është tepër e nevojshme për lubrifikimin e tyre. Gjatë qëndrimit para kompjuterit njeriu e largon mendjen dhe përqendrohet vetëm tek puna që paraqitet aty dhe numri i kapsitjeve të syrit ulet ose zerohet. "Kontrolli im elektronik" do të korrigjojë gjithmonë/vazhdimisht veprimet tona, që ne mos të kemi probleme shëndetësore më vonë.

Pajisja shumë funksionale dhe e avancuar i mbron të gjitha grupmoshat, të cilat navigojnë në internet apo punojnë me programe të ndryshme kompjuterike. Kjo pajisje mund të përdoret në kolegje, shkolla dhe universitete, të cilat e kanë shumë të nevojshme, sepse kompjuteri përdoret nga studentët dhe nxënësit, duke përfshirë fëmijë dhe adoleshentë të moshave të ndryshme, apo nga administrata. Përdorim të gjerë të kësaj pajisje mund të kemi në institucione shtetërore, zyra, banka, spitale, kompani dhe sipërmarrje të ndryshme, pra kudo ku kompjuteri është një nga mjetet kryesore për përpunimin/kalkulimin e informacionit dhe funksionimin sa më mirë të punëve të përditshme.

Fjalë çelës: *kontroll, qëndrim, kompjuter, elektronikë, paisje.*

MY ELECTRONIC CONTROL

Abstract

The project which we will show is connected with an electronic tool; it makes a lot of functions which we need to be healthy when we stay in front of the computer.

The tool called “My electronic control”, which play un interesting role on our daily work. This tool may controls, independently, when we are on computer. It will control strictly our staying in front of computer, how we will stay etc. With this tool we will get the physic distance with the monitor. It controls the eyes for keeping them lubricated. When the person stays behind the monitor he is only concentrated just to the work and the number of opening the eyes goes to minus or zero. “My electronic control” remembers and erases the errors, after we don’t have problems of health.

This tool protects people of all the ages, who navigate on internet or work with different computer programmes. It will be used at schools and universities, which need this because the computer is using by young people, including children and adolescents of different ages or the administration.

It should have a big usage in the offices, banks, hospitals, different companies, everywhere where the computer is used for calculating information in order to have a good function of our work day.

Keywords: *control, staying, computer, electronic, tools.*

1. Hyrje

Në të gjitha fushat njerëzore përdorimi i kompjuterit çdo ditë e më tepër sa vjen dhe bëhet më i domosdoshëm. Duke patur një përdorim të gjerë nga të gjitha grupmoshat dhe përdorimi i tij ditor sa vjen e rritet, ai po krijon çdo ditë e më shumë probleme fizike. Duke vëzhguar këto probleme, vendosëm të bëjmë këtë studim, sesi mund të mbrohemi nga dëmtimet fizike që na sjell qëndrimi jo korrekt përpara kompjuterit. Pajisja që do të realizojmë/krijojmë quhet “Kontrolli im elektronik”. Ajo përbëhet nga disa qarqe elektronike të integruara dhe të programuara në mënyrë që të koordinojë sa më mirë sensorët që kryejnë funksionet që ne duam për kontrollin e ruajtjes të distancës së përdoruesve. Pajisja në bazë të disa testeve paraprake të jep mundësinë të përshtatesh lehtësisht me të, pa u bërë e bezdisshme për përdoruesin.

2. Funksionimi dhe përshkrimi i pajisjes “Kontrolli im elektronik”

Pajisja “Kontrolli im elektronik” do të funksionojë në mënyrë të thjeshtë. Ajo do të instalohet lehtësisht në njësinë e kompjuterit dhe do të jetë një prej pajisjeve të jashtme të tij. “Kontrolli im elektronik” do të vendoset në monitor sipër ekranit sikurse kamerat e kompjuterit. Ekziston mundësia që sensorët të jenë në dy versione: versioni i parë do të jetë i bashkangjitur në një kamera kompjuteri, kurse versioni i dytë mund të mos ketë kamera, por do të kryejë funksionin e kontrolluesit në distancë. Pajisja “Kontrolli im elektronik” do të përlloraget të ruajë distancën e qëndrimit standard, siç paraqitet në Figurën 1.



Figura 1. Qëndrimi i duhur përpara kompjuterit [1]

Qëndrimet në mënyrë të gabuar dhe jostandarde, që vijnë natyrshëm pas orëve të gjata para ekranit të kompjuterit, krijojnë pasojë shëndetësore në fizikun tonë. Pasojat kryesisht ndodhin në shtyllën kurrizore, siç është paraqitur në Figurat 2 dhe 3.



Figura 2. Qëndrimi i gabuar përpara monitorit [2]

Gjithashtu, probleme ndodhin edhe në pjesën e qafës, siç tregohet në Figurën 4.



Figura 3. Pasojat negative gjatë qëndrimit të gabuar në zyrë [3]



Figura. 4 Pasojat negative gjatë qëndrimit të gabuar përpara kompjuterit [4]

“Kontrolli im elektronik” kontrollon dhe kapsitjen e syve, e cila është e domosdoshme për lubrifikimin e tyre të njëpasnjëshëm. Moskapsitja e syve dhe neglizhenca që mund të ndodhë pas orëve të gjata të punës bëhen shqetësuese dhe na sjellin/shfaqin probleme të dukshme, sikurse pasqyrohet në Figurën 5.



Figura 5. Pasoja negative në shikim nga qëndrimi jo i rregullt në kompjuter [5]

Pajisja “Kontrolli im elektronik” do të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme lëvizjet tona në mënyrë që të mos kemi probleme me qëndrimin. Në momentin e qëndrimit jokorrekt pajisja do të sinjalizojë në disa mënyra:

- me tabela informuese në ekran;
- gabime;
- sinjale akustike, etj.

Pajisja, kur kupton se përdoruesi anashkalon përdorimin korrekt përpara kompjuterit, e penalizon atë duke bllokuar kompjuterin në shenjë “dënimi”, që përdoruesi mos ta përdorë atë për disa minuta. Aktivizimi do të bëhet përsëri pas disa minutash, pasi të mbarojë minutazhi i caktuar. Metoda e dënimit vlen për të bërë një çlodhje për disa minuta (periudhë e shkurtër kohore).

Aparatet celulare apo pajisjet e ndryshme kryesisht elektronike, të cilat duan mbrojtje dhe kujdes, i pajisim me mbështjellës të certifikuar nga të gjitha anët, edhe ne duhet të kemi mbrojtje të lartë nga këto shkaqe, të cilat na dëmtojnë po i tejkaluam normat. Pajisja “Kontrolli im elektronik” do të kishte shumë interes për kompanitë e kamerave, të cilat duke e bashkëngjitur këtë risi të

domosdoshme, do të bënin diferencë në treg duke u renditur në krye të listës.

Kujdesi dhe rregullat janë parësore dhe të nevojshme për ne, por gjithmonë i lëmë vend për përmirësim duke i neglizhuar ato derisa arrijmë në një shkallë që është e parikuperueshme. Për këtë na nevojiten gjithmonë e më tepër pajisje të ngjashme, që të kujdesemi më mirë për shëndetin tonë, sidomos në mënyrë të veçantë kjo pajisje gjen përdorim edhe për fëmijët.

Vlen të përmendim sensorët edhe kamerat e automjeteve që tashmë janë bërë të domosdoshme në përdorim, duke e bërë gjithnjë e më të paktë funksionimin pa to. Në të njëjtën mënyrë edhe pajisja “Kontrolli im elektronik” gjen vend te kompjuterat.

Në bazë të studimeve dhe konsultave me mjekë specialistë të fushës, një pajisje e tillë do të ulë ndjeshëm deri në disa shifra minimale përdorimin e syzeve, si dhe do të ketë më pak nevoja për përdorimin e aksesorëve për përmirësimin dhe mbajtjen drejt të shtyllës kurrizore.

3. Përfundime

Pajisja “Kontrolli im elektronik” do të luajë një rol të rëndësishëm në jetën dhe shëndetin e të gjithë përdoruesve të kompjuterit, duke përfshirë të gjitha grupmoshat. Kjo pajisje duke kontrolluar në mënyrë standarde qëndrimin e trupit dhe kapsitjen e syve, do të bëjë të mundur që, duke filluar nga fëmijët e deri tek moshë e tretë, të shërbejë si një mbrojtës dhe parandalues automatik ndaj rrezikut të dëmtimit të shtyllës kurrizore, si dhe të cilësisë së shikimit. Pra, “Kontrolli im elektronik” do të ketë përdorim dhe funksionim të gjerë duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm te popullata (përdoruesit e kompjuterit).

Referenca

[1] Qëndrimi i duhur përpara kompjuterit

https://www.google.com/url?sa=i&source=images&cd=&cad=rja&uact=8&ved=2ahUKEwionOr8_4ziAhXsMewKHXQVDFsQjRx6BAgBEAU&url=https%3A%2F%2Fkohaislame.com%2Fshkencetaret-rekomandojne-si-te-ulemi-para-kompjuterit-dhe-mos-ta-demtojme-shendetin_foto%2F&psig=AovVaw3HjUqorZV2MgFty1GeDxe3&ust=1557441191428049

Data e fundit e aksesimit 23.04.2019

[2] Qëndrim i gabuar

<https://www.google.com/url?sa=i&source=images&cd=&cad=rja&uact=8&ved=2ahUKEwit5bjw-IziAhWGCeWkHW8yBscQjRx6BAgBEAU&url=http%3A%2F%2Fwww.tiranapost.al%2Fsa-rrezikon-privatesia-e-femijeve-ne-internet%2F&psig=AovVaw16-3B3jmae6ubyc5VBHz>

Data e fundit e aksesimit 23.04.2019

[3] Pasojat negative të qëndrimit të gabuar

<https://www.google.com/url?sa=i&source=images&cd=&ved=2ahUKEwiAuOe4gI3iAhXQ-qQKHW3pB1gQjRx6BAgBEAU&url=https%3A%2F%2Fshqiptari.net%2Fpse-duhet-te-mbani-trupin-tuaj-drejte-gjate-qendrimit-para-kompjuterit%2F&psig=AovVaw3HjUqorZV2MgFty1GeDxe3&ust=1557441191428049>

Data e fundit e aksesimit 23.04.2019

[4] Pasojat negative të qëndrimit të gabuar përpara kompjuterit

<http://www.albeu.com/foto-lajm/rrini-gjithe-diten-para-kompjuterit-keshtu-mund-ti-lehtesoni-dhimbjet-e-qafes/451782/1/#foto>

Data e fundit e aksesimit 23.04.2019

[5] Pasoja negative në shikim nga qëndrimi jo i rregullt në kompjuter

<https://www.google.com/url?sa=i&source=images&cd=&cad=rja&uact=8&ved=2ahUKEwiU6Nmg94ziAhUKuaQKHf5RCXkQjRx6BAgBEAU&url=http%3A%2F%2Fwww.gazetadita.al%2F10-keshilla-per-te-mbrojtur-syte-nga-kompjuteri-dhe-celulari%2F&psig=AovVaw2mwmh9UQSmbH8r70WnMv7R&ust=1557438830782603>

Data e fundit e aksesimit 23.04.2019